

Teoritë sipas caktit të feskimit

Sipas caktit të feskimit, teoritë mund të ndahen në tri kategori kryesore: a) autori i veprës dhe rrethanat krijuese, b) teksti i veprës, dhe c) reagimi i lexuesit. Kjo ndamja është e arsyeshme sepse në fund të fundit veprat kanë: autor > tekst > lexues. Vepra nuk shkruhet për vete; nevojshisht, ajo duhet të përçohet nëpërmjet një mediumi (tekst, film, imazhe); dhe ajo duhet të konsumohet prej marrësit, p.sh., një lexuesi, shikuesi, dashamirësi të artit, etj.

Me Fokus Autorin

Në lëmje, autori 'hidhet' në një bashkësi specifike, në një kohë specifike, dhe në një vend specifik, ku ai zhvillon pikpamjet e tij psikologjike, sociologjike, politike, artistike, e filozofike. Prej këtij kandvështrimi vepra mund të vlersohet duke hulumtua biografinë, psikologjinë, dhe kushtet ekonomike e shoqërore.

Biografia

Këtu kritiku febron të kaluomen e autorit në lidhje me edukimin dhe rrethanat kulturore e shoqërore. Disa mendojnë që biografia nuk e ndikon veprën e autorit, por autori nuk formohet në vakum. Ai i përket një bashkësie me doke, ligje, e tradita specifike, ku mund të përfshihen edhe feja ose mungesa e saj edhe gjendja ekonomike e kulturore

Psikologjia

Duke u bazua në parime psikologjike (behaviorism, kognitivizëm, psiko-dinamikë, psikologji egzistenciale, etj.), kritiku mund të përpiqet të interpretojë botën e autorit dhe të personazheve. Lexime të tilla mund të gjenden në perspektivat teorike të post-strukturalizmit (Lakan) dhe feminizmit (Kristeva).

Konteksti

Konteksti mund të jetë i thjeshtë, p.sh., Mjedja shkroi në periodën e pavarësisë. Në riní ai u pat ndikuar prej romantizmit, kurse në pjekuní prej klasicizmit. Disa kritikë mund të febrojnë rrethanat *ekonomike, politike, fétare, historike, e filozofike* të mjedisit ku u rrit dhe u formua autori. Pastaj, ata mund të aplikojnë parime të nxjerruna prej teorish të ndryshme sociologjike, ku ata përpiqen të tregojnë se në çfarë mase krijimi i autorit është produkt i situatës ku ai u lind dhe u formua. Për disá, autori mund të kalojë krejt në sfond të veprës.

Në kontekstin e të majtës, rrethanat e formimit të autorit mund të interpretohen nëpërmjet formash të ndryshme kritike, p.sh., *historicismi i rí, materializmi kultural, studimet kulturore, studimet postkoloniale, teoria kritike e racës a racizmit*, e të tjera.

Me Fokus Tekstin

Për disa, vepra letrare a artistike përmban në vetvete edhe interpretimin e saj.

Kritika e Ré

Sipas kësaj teorie, biografia dhe rrethanat shoqërore e historike të autorit janë të parandësishme; është vetë teksti ai që përmban kumtin, mjetet me të cilat ndërtohet kumti, dhe shpjegimin e kumtit. E vërteta e tekstit mund të nxirret prej 'leximit prej afër' (en. close reading) të veprës, ku kërkohet një hetim i detajuar rreth *parimeve unifikuese dhe tensionit të tekstit*.

Narrativizmi

Me qartësi torinë narrativiste, skema pasuese e krahason atë me kritikën historike dhe reagimin e lexuesit.

Kritika narrativiste: autori < **TEKSTI** > audiencia

Kritika historike: **AUTORI** > teksti > audiencia

Reagimi i lexuesit: autori < teksti < **AUDIENCA**

Kështu, kur lexojmë Homerin, ne nuk shqetsohemi me ditë nëse *Iliada dhe Odiseja* kishin një autor të vetëm apo disa sish ose si i interpreton ato një lexues i veçantë, por rreth asaj që thohet në këto dy vepra.

Përkufizimi:

Kritika narrativiste anglohet në atë që thohet në tekst, jo në mjedisin historik ku u krijua teksti apo në reagimin e lexuesit të tekstit. Këtu, u jepet rëndësi aspekteve letrare (jo faktike) të tekstit si *mjedisi, narratori, komploti, karakterizimi, simbolizmi, tema, dhe retorika*.

Analiza

1. Gjithmonë duke e konsiderua tekstin si tregim, kryhet një lexim i kujdesëshëm ku identifikohen **mjedisi** (Kur? dhe Ku?), **pikvështrimi** (prej Ku?, **komploti** (Çka? - ngjarjet e zgjedhuna për këtë tregim), **personazhet** (Kush?), dhe **si** (teknikat letrare) e **përse** (retorika). Kështu:

mjedisi ku? e kur?

pikshikimi Prej ku e sheh narratori tregimin?

komploti Cilat ngjarje u zgjodhën për këtë rrëfim, dhe përse këto ngjarje; përse jo ngjarje të tjera?

personazhet Kush merr pjesë në këtë ngjarje, direktazi ose jodirektazi?

teknikat letrare Çfarë mjeshtrie përdorë autori me rrëfye tregimin?

retorika Cili është qëllimi i autorit dhe sa efektiv është ai në arritjen e këtij qëllimi?

Me fokus Rolin e Lexuesit (Rezeptionsästhetik)

Teoria e *reagimit të lexuesit* (en. reader response theory) përqipet me kuptua se çka ndodhë në mendjen dhe me ndjenjat e lexuesit gjatë procesit të leximit.

Larmia e Lexuesve

Jo të gjithë lexuesit reagojnë në të njëjtën mënyrë, prandaj, në mes tjerash, duhet me marrë parasysh edhe *moshën, gjininë, statusin shoqëror, edukimin, pikëpamjet filozofike, e racën e lexuesit*. Sipas Jaussit, kuptimi që lexuesi nxjerrë prej tekstit nuk është i fiksuom. Ai merr formë dhe zhvillohet duke u bazua në rrethanat historike e kulturore të lexuesit.

Mbushja e zbraztinave

Gjatë leximit, çdo lexues haset me koncepte ose informacion që nuk e kupton, prandaj atij ose asaj i duhet me i mbushë këto zbraztina me aq sa dihet. Ky veprim mund të quhet *pjesëmarrje* në ndërtimin e kuptimit të tekstit.

Historia e reagimit të lexuesit

Lexuesit reagojnë jo vetëm në mënyra të veçanta ndaj një teksti që ata lexojnë, por edhe në varsi prej kohës në të cilën ata jetojnë.